



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 998/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Levizja Vetëvendosje (LVV) paraqitur kundër Komisionerit Hasan Kerolli për shkak të parregullsive gjate procesit zgjedhor për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

### VENDIM

**I. Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë.

**II. Hasan Kerollit** komisioner nga rradhët e LDK-së, i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 2 vite nën autoritetin e KQZ-së si kandidat apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor

### Arsyetim

PZAP-i, më datë 02.12.2013 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Levizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën theksohet se me datën 01.Dhjetor 2013, në ora 07:30 jemi njoftuar nga komisionerja e LVV-se Suliote Aliu-Lahu se në vendvotimin 1909e/04 komisioneri Hasan Kerolli me datë të lindjes 11.06.1988 me nr të leternjoftimit 1174854412, i cili ishte anetar i kshillit të vendvotimit 1909e/08 ka ardhur të votojë në vendvotimin 1909e/04. Pasiqë i njëjti ishte i evidentuar në LPV-ne e këtij vendvotimi. I njëjti pasi ka votuar ka fotografuar votën e tij. Rasti është shënuar në librin e votimit nga komisionerja Suliote Aliu Lahu.

Veprimi i komisionerit Hasan Kerolli përben shkelje të ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nënen 89.4 si dhe rregullores Zgjedhore. Poashtu veprimi i tillë përben figurën e veprës penale të parapare me nënen 218 par.1 lidhur me par.3 të kodit Penal të Republikës së Kosovës. Në bazë të pretendimeve të shprehura në këtë ankesë, si dhe deshmime të deshmuesve të kërkuar nga PZAP-i që sipas bazës ligjore të shprehur në nënen 32.2 të ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, të shqiptojë sanksionin adekuat ndaj shkeljesit Hasan Kerolli.

Kesaj ankesë doti bashklidhen deklaratat personale të komisioneres Suliote Aliu-Lahu nga LVV-ja dhe vezhguesit Donika Alihajdaraj dhe Shqiprim Gashi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik LDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 03.12.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 04.12.2013, në ora 10:00.

PZAP-i, për rastin në fjalë pranoi pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK distancohet nga rasti në fjalë pasi që siç thonë se personi i supozuar për shkeljen e mundshme është person i cili ka përfunduar trajnimet dhe përgatitjet për të qenë i informuar për shkeljet e mundshme dhe se kjo ankesë nuk mund të i drejtohet subjektit politik LDK pasi që kjo hynë në fushën e veprimeve individuale të një personi të moshës madhore e i cili ka njohuri për veprimin e ndaluar. Poashtu sipas LDK-se parashtruesi i ankesës LVV nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të

vërtetuar pretendimet e tija dhe se në mungesës të fakteve propozon që ankesa të hidhet poshtë pasi që ankesa është e qëllimshme dhe ka për qëllim për të dëmtuar imazhin e LDK-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

PZAP-i konstatoi se nga deshmite e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij dhe nga provat e administruara nga PZAP-i shihet se komisionari Hasan Kerolli anëtarë i këshillit të vendvotimit 1909e/08 gjatë ditës së zgjedhjeve për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale ka shkuar për të votuar në vendvotimin 1909e/04 dhe i njëjti pasi që ka votuar ka fotografuar votën e tij veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 89.4 të LZP-së dhe nenit 15.4 të Rregulles Zgjedhore 09/2013 të KQZ-së ku theksohet se secili votues e plotëson fletëvotimin e vetë në fshehtësi mbrapa kabinës së votimit. Prandaj nga arsyet e lartcekura me qëllim të evitimit të shkeljes së potencuar më lartë dhe në pajtim me dispozitat e lartcekura ligjore PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 lidhur me nenin 120. 3 pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 998/2013 më datën 04.12.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**

#### ***Këshillë Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*

